

Informator për pajisje me patentë shoferë

1) Dokumentet dhe Procedurat për pajisjen me patentë shoferë të Republikës së Kosovës për herë të parë dhe shtim të kategorive pas dhënies së provimit për shoferë për kategorinë përkatëse.

Bazë juridike Ligji mbi Sigurinë në Komunikacion Rrugor -Nr/02/L-70 dhe Udhëzimi Administrativ MPB-Nr. 15/2013-MPB.

Kërkesa për pajisje me patentë shoferë për herë të parë ose shtim të kategorive bëhet në njësitë rajonale të Ministrisë së Infrastrukturës ku është dhënë provimi për shoferë: (Prishtinë , Prizren, Mitrovicë, Gjakovë ,Pejë, Ferizaj, Gjilan).

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Certifikata mbi dhënien e provimit.
- Kopja e letërnjoftimit ose e pasaportës së Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Kopjen e patentë shoferit në rast se ka bërë shtimin e kategorive.
- Fletëpagesa në shumën prej 15 euro.
- Dëshmi në rastin e ndërrimit të të dhënave personale.
- Certifikatën shëndetësore.

2) Për ndërrimin e patentë shoferit të UNMIK-ut me patentë shoferë të Republikës së Kosovës.

Bazë juridike Udhëzimi Administrativ MPB-Nr. 22/2015 të datës 19/11/2015.

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Kopjen e patentë shoferit të UNMIK-ut.
- Prezantimi i letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Prezantimi i certifikatës shëndetësore për patentë shoferë për kategoritë profesionale (A1. A. C1. C1E. C. CE. D1. D1E. D. DE). Ndërsa për qytetarët mbi moshën 65 vjeçare edhe për kategorinë (B,BE).
- Raporti policor. *(Ky dokument kërkohet krahas dokumenteve tjera të lartpërmendura në rast se pala e ka humbur Patentë Shoferin e UNMIK-ut).*
- Fletëpagesa prej 15 Euro.

3) Për ndërrimin e patentë shoferit të ish RFJ-së- brenda Kosovës me patentë shoferë të Republikës së Kosovës.

Bazë juridike Udhëzimi Administrativ Nr.MPB- 22/2015 të datës 19-11-2015.

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Kopjen e vërtetuar të patentë shoferit të ish RFJ –së (nëse e posedon aplikanti).
- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Certifikata shëndetësore për kategoritë profesionale. (A1. A. C1. C1E. C. CE. D1. D1E . D. DE). Ndërsa për qytetarët mbi moshën 65 vjeçare edhe për kategorinë (B, BE).
- Dosja ose kartoni i fotokopjuar në arkivin komunal për patentë shoferin e ish RFJ i nënshkruar nga Zyrtari i ZSHPSH-së.
- Fletëpagesa prej 15 euro.

04) Për përmirësimin e dhënave në patentë shoferë të Republikës së Kosovës.

Bazë juridike Udhëzimi Administrativ Nr-MPB- 22/2015 të datë datës 19-11-2015.

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Kopjen e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.
- Kopjen e patentë shoferit të Republikës së Kosovës me gabime.
- Kopjen e dëshmisë nga organi kompetent, varësisht nga natyra e gabimit.
- Fletëpagesa prej 15 euro.

(Korrigjimin e patentë shoferit mund ta kërkojnë edhe personat, të cilët kanë bërë ndryshimin e të dhënave personale, ndërrimin e emrit ose mbiemrit në bazë të kopjes së letërnjoftimit të Republikës së Kosovës dhe dokumentit të organit kompetent mbi atë ndryshim).

5) Për pajisje me patentë shoferë të Republikës së Kosovës pas humbjes, vjedhjes ose dëmtimit.

Bazë juridike Udhëzimi Administrativ Nr- MPB-22/2015- të datës 19-11-2015.

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Raporti policor për humbjen e Patentë Shoferit.
- Prezanton kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës të Republikës së Kosovës me afat vlefshmërie.

- Prezanton patentë shoferin në rast dëmtimi.
- Fletëpagesa prej 15 euro.

6) Për vazhdimin e patentë shoferit të Republikës së Kosovës.

Bazë juridike Udhëzimi Administrativ Nr- MPB 22/2015- të datës 19-11-2015.

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente.

Për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së patentë shoferit aplikuesi mund të aplikojë 6 muaj para skadimit të aftit të vlefshmërisë.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Prezanton patentë shoferin dhe letërnjoftimin e Republikës së Kosovës.
- Prezanton certifikatën shëndetësore të vlefshme për patentë shoferë për kategoritë profesionale. (A1. A. C1. C. CE. D1. D. DE), si dhe për të gjithë kandidatët më të vjetër se 65 vite edhe për kategorinë B,BE.
- Raporti policor .
(Ky dokument kërkohet në rast se pala katë humbur Patentë Shoferin e RKS-ut me afat të skaduar).
- Fletëpagesa prej 15 euro.

Për ndërrimin e patentë shoferit të lëshuar nga shtetet e huaja anëtare të BE-së me patentë shoferë të Republikës së Kosovës.

Bazë juridike Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2013-MPB si dhe Ligji mbi Sigurinë në Komunikacion Rrugor Nr/02/L-70.

Kërkesa paraqitet në Qendrat për Pajisje me Dokumente.

Në këto raste kërkohen këto dokumente:

- Përkthimi i patentë shoferit të huaj në një të njëjtën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës nga përkthyesi i autorizuar.
 - Për shtetasit e Republikës së Kosovës dorëzohet kopja e letërnjoftimit ose e pasaportës së Republikës së Kosovës, ndërsa për shtetasit e huaj, kopja e letërnjoftimit për të huaj me leje qëndrimi mbi 6 muaj;
 - Me rastin e aplikimit, personi dorëzon patentë shoferin origjinal dhe duhet të prezantojë origjinalin e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës.
- Certifikatën shëndetësore të vlefshme për patentë shoferë për kategoritë profesionale. (A1. A. C1. C. CE. D1. D. DE), si dhe për të gjithë kandidatët më të vjetër se 65 vite edhe për kategorinë B,BE.

- Fletëpagesa në vlerë prej 15€.